



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

PROCESVERBAL

Konsultim Publik me Qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Pejës për periudhën 2027-2029

Data: 19.06.2026

Ora: 12:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal të Pejës

Të pranishëm:

- Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri;
- Drejtorë të drejtorive komunale;
- Anëtarët e Grupit Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027-2029;
- Përfaqësues të administratës komunale;
- Qytetarë dhe përfaqësues të lokaliteteve përkatëse.

Rendi i ditës:

1. Prezantimi i Kornizës Buxhetore dhe planifikimit të buxhetit për periudhën 2027-2029;
2. Diskutimi i prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve;
3. Evidentimi i propozimeve për investime kapitale dhe projekte infrastrukturore.

Hyrje

Takimi u mbajt në praninë e Kryetarit të Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri, drejtorëve të drejtorive komunale, anëtarëve të Grupit Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027-2029, përfaqësuesve të administratës komunale dhe qytetarëve të interesuar.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Rexhep Kurtbogaj, i cili përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi lidhur me procesin e planifikimit buxhetor, afatet ligjore dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve komunale.

Më pas, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dielleza Berisha prezantoi Kornizën Buxhetore të Komunës së Pejës për periudhën 2027-2029, duke ofruar informata mbi kufijtë buxhetorë të përcaktuar sipas Qarkores Buxhetore dhe mënyrën e planifikimit të shpenzimeve komunale.

Në kuadër të prezantimit u paraqit struktura e buxhetit për vitin 2027 si vijon:

Përshkrimi	Shuma (€)
Paga dhe mëditje	22,422,494.00
Mallra dhe shërbime	5,733,393.00
Shpenzime komunale	1,164,401.00
Subvencione dhe transfere	1,430,209.00
Shpenzime kapitale	13,369,181.00
Totali	44,119,678.00

Pas prezantimit u hap diskutimi me qytetarët, të cilët paraqitën kërkesat dhe propozimet e tyre lidhur me nevojat prioritare të komunitetit.

Kërkesat dhe propozimet e qytetarëve

1. Z. Shefqet Kelmendi

Paraqiti kërkesën për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës në lagjen ku banon. Ai theksoi se gjendja aktuale e rrugës vështirëson qarkullimin e banorëve dhe kërkoi që ky projekt të trajtohet si prioritet në planifikimin e investimeve kapitale.

2. Z. Agim Haxhijaj

Shprehu shqetësimin për gjendjen e rrugëve lokale dhe nevojën për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Ai potencoi se investimet në këtë fushë do të ndikonin drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së jetës së banorëve.

3. Z. Xhevat Kajolli

Paraqiti tri kërkesa prioritare:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik;
- Mbështetjen e projekteve të tjera me interes për komunitetin lokal.

Ai theksoi se këto investime do të kontribuonin në zhvillimin e zonës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët.

4. Z. Agim Nikqi

Kërkoi investime në rrugët e lagjes së tij dhe përmirësimin e infrastrukturës lokale, duke potencuar nevojën për qasje më të mirë dhe kushte më të përshtatshme për banorët.

5. Z. Jakup Lajqi

Paraqiti kërkesë për rregullimin e rrugëve lokale dhe trajtimin e problemeve infrastrukturore të evidentuara nga banorët. Ai kërkoi që këto investime të përfshihen në planifikimin e ardhshëm buxhetor.

6. Z. Kadri Mavraj

Paraqiti disa kërkesa me interes për komunitetin:

- Mirëmbajtjen dhe trajtimin e rrugëve lokale;
- Përmirësimin e infrastrukturës publike;
- Investime në projekte zhvillimore dhe shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.

Diskutimet dhe përgjigjet


Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri, falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive dhe kontributin e tyre në procesin e planifikimit buxhetor. Ai theksoi se kërkesat e paraqitura do të trajtohen me seriozitet nga drejtoritë përkatëse dhe do të shqyrtohen në kuadër të prioritetëve komunale dhe mundësive buxhetore.

Përfaqësuesit e Grupit Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027-2029 sqaruan procedurat e planifikimit buxhetor dhe njoftuan të pranishmit se të gjitha propozimet e paraqitura do të evidentohen dhe do të vlerësohen gjatë procesit të hartimit të buxhetit.

Të gjitha kërkesat dhe propozimet e paraqitura gjatë dëgjimit publik u evidentuan në procesverbal dhe do të shqyrtohen gjatë hartimit të Buxhetit të Komunës së Pejës për periudhën 2027-2029, në përputhje me prioritetet zhvillimore dhe mundësitë buxhetore.

Komuna e Pejës mbetet e përkushtuar për të siguruar transparencë, pjesëmarrje qytetare dhe planifikim të qëndrueshëm të investimeve publike, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimit të përgjithshëm të komunës.

Mbajtësi i procesverbalit: Fatmir Imami

Nënshkrimi: _____


Kryesuesi i Grupit Punues: Gazmend Turku

Nënshkrimi: _____




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

LISTA E NËNSHKRIMEVE TË PJESAMARRËSVE NË KONSULTIM














KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2027-2029

Vendi: **Salla e Kuvendit Komunal**

Data: **19.06.2026**

Ora: **12:00**

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	DRITA KRASNIOTI	K-PEJE	
2	Arita Juchin	K-PEJE	
3	AGIM HAXHIJAS	K.L. TICEBOVIA	
4	Elbani Yezzi	K.L. Kristolli	
5	JAKUP LAIC	K.L. JARDANI II	
6	SAJKA DRANSOČU	KOMUNA PEJE	
7	JALIGET DUKU	KOMUNA PEJE	
8	DRILON KOLKONDI	QKMF	
9	Egzon Krashti	DOBËRDOL	
10	Kastrat Belegu	K. PEJE	
11	Behim Morina	LIXHI	
12	Hester Gaceli	OSCE	
13	EDJON MALOMU	PEJE	
14	SHADAN LAJQI	PEPIQI	
15	BALI META	F.SH. LESHAN	
16	AGIM NIKAI	KRRORADIEVI	

17			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Osman Mulliqi	B.2. Poshqiz	
19	Xhevat Kajolli		
20	TAHIR SHALA	B.2. BAKAN	
21	KADEI MAVRAJ	K.L. Fshatare	
22	Islam Huga	Kristali 3	
23	BEJHAN KRASHI	K.B.2. KARAGAR	
24	Muhamet Dupjak	ODBORNIK u S.D.A	
25	NASER BIRAKUARI	UTOMILE	
26	Elvedina Jug	HAXHI ZEKA	
27	Vili SYLON	HAXHI ZEKA	
28	JETA EXEMI		
29	EGZON LAPAS		
30	Meutari Bilbashi	Fidanit 4	
31	Blota Beqeli	K.K. Pejo	
32	GABRIELI TUKA	1626	
33	Klaser Gjeq	DKA	
34	Vullnet Cusine	DFRS	
35	Diellera Beqeli	K.K. Pejo	
36	GAZMEND MUHAMET	=	
37	AGROU NIKCI	=	
38	Horçe Hoxhaj		
39	Fotunë Tugari	DBR	
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Me OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe klubet sportive.

Salla e Kuvendit Komunal të Pejës

Dëgjimi ka filluar në ora: 12:00

Datë: 03.08.2026

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 12:00, u mbajt dëgjimi publik me OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe klubet sportive.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore, siç janë:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49;

Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00;

Shpenzime komunale: 1,157,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00;

Shpenzime kapitale: 14,565,179.51;

Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

Kanita Shala: Jam nxënëse e shkollës fillore “Dardania” në Pejë, ne anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), së bashku me fëmijët e grupit Respect Our Rights (ROR), kemi kënaqësinë të jemi pjesë e këtij dëgjimi buxhetor për vitin 2027. Sot para jush, po paraqesim disa kërkesa, që lidhen drejtpërdrejt me interesin më të mirë të fëmijëve dhe bashkëmoshatarëve tanë, në përputhje me detyrimet, që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Të nderuar,

Përmes kësaj letre dëshirojmë të adresojmë disa çështje, që kanë të bëjnë me fushën e arsimit, shërbimeve publike, shëndetësisë, si dhe në bashkëpunim me Zyrtaren për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Riintegrim, znj.Drita Krasniqi. Këto propozime janë rezultat i takimeve, diskutimeve dhe punëtorive të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, ku të gjithë anëtarët e Asamblesë i kemi ndarë shqetësimet, përvojat dhe nevojat tona, me qëllim të përmirësimit të kushteve të mësimi, mirëqenies dhe cilësisë së jetës së të gjithë fëmijëve të Komunës së Pejës.

Andaj, kërkojmë nga ju që t'i merrni parasysh kërkesat tona dhe që ato të përfshihen në procesverbalin e dëgjimit buxhetor të ditës së sotme.

Kërkesat e Asamblesë Komunale të Fëmijëve janë:

1.Blerja dhe furnizimi me banka të reja dhe të përshtatshme për nxënësit:

Ndërrimi i bankave të vjetra, të dëmtuara ose jo ergonomike me mobilje të reja, të përshtatshme me moshën dhe nevojat fizike të nxënësve.

Përdorimi i mobilieve, që përmbushin standardet ergonomike, duke ofruar rehati dhe duke ndihmuar përqendrimin në procesin mësimor.

2.Rritja e sigurisë në objektet shkollore:

Vendosja e kamerave të sigurisë dhe sigurimi i pranisë së stafit mbikëqyrës, veçanërisht gjatë pushimeve dhe pas përfundimit të orarit mësimor.

Hartimi i planeve të evakuimit dhe organizimi i ushtrimeve praktike për reagim në raste emergjente (zjarr, tërmet etj.).

Mbyllja e hyrjeve të pasigurta dhe kontrolli i vizitorëve në ambientet shkollore.

3.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve pranë shkollave:

Ndërtimi i trotuareve të sigurt në afërsi të shkollave, ku ato mungojnë, për të mbrojtur nxënësit gjatë lëvizjes për në shkollë dhe kthimit në shtëpi.

Vendosja e pengesave fizike për të parandaluar parkimin e automjeteve në trotuare nga prindërit, stafi i shkollës apo drejtuesit e tjerë të automjeteve.

Sigurimi i ndriçimit të mjaftueshëm dhe sinjalizimit të duhur për këmbësorët pranë shkollave.

4.Pajisja e shkollave me kabinete të teknologjisë informative:

Modernizimi i kabineteve të informatikës me kompjuterë të rinj dhe pajisje bashkëkohore.

Sigurimi i internetit me shpejtësi të lartë dhe programeve edukative, që mbështesin zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve.

Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënësit, për përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.

Sara Camaj: Jam nxënëse në SHFMU “Lidhja e Pejës” në Novosellë, po i lexoj disa nga kërkesat, siç janë:

5.Buxhet shtesë për përmirësimin e higjienës në shkolla:

Investime për përmirësimin e kushteve sanitare në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.

Sigurimi i ujit të rrjedhshëm, sapunit dhe letrës higjienike në të gjitha tualetet.

Pastrim i rregullt dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e ambienteve sanitare.

6. Punësimi i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta:

Sigurimi i asistentëve profesionalë për nxënësit me nevoja të veçanta, në mënyrë që ata të marrin mbështetjen e nevojshme gjatë procesit mësimor.

Trajnimi i mësimdhënësve për qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetje individuale për secilin nxënës.

Krijimi i kushteve për një mjedis mësimor gjithëpërfshirës, ku të gjithë fëmijët të kenë mundësi të barabarta për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.

7. Buxhet i veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve:

Kërkojmë ndarjen e një buxheti të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, me qëllim të realizimit të aktiviteteve tona të rregullta dhe zbatimit të planit vjetor të punës në bashkëpunim me Zyrtaren për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Riintegrim në Komunën e Pejës, znj. Drita Krasniqi, duke përfshirë:

Organizimin e tryezave të rrumbullakëta me nxënës, mësimdhënës, prindër dhe përfaqësues të institucioneve për të diskutuar ndikimin e bullizmit, paragjytimeve dhe diskriminimit tek fëmijët.

Organizimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe punëtorive edukative në shkolla për promovimin e respektit, tolerancës, gjithëpërfshirjes dhe shëndetit mendor.

Sigurimin e mbështetjes psiko-sociale për nxënësit dhe fuqizimin e mekanizmave shkollorë për parandalimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të bullizmit.

Duke u bazuar në parimet e buxhetimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve kërkojmë, që Komuna e Pejës të planifikojë një linjë të veçantë buxhetore për fëmijët, përmes së cilës të mbështeten nevojat dhe prioritetet e identifikuara nga fëmijët, si dhe aktivitetet e Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Një planifikim i tillë do të mundësonte pjesëmarrje më kuptimplotë të fëmijëve në vendimmarrje dhe do të siguronte, që të drejtat dhe interesat e tyre të reflektohen në politikat dhe investimet komunale.

Jemi të bindur se investimi në mirëqenien, arsimin, sigurinë dhe pjesëmarrjen e fëmijëve është investim për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Pejës. Prandaj, ju ftojmë, që kërkesat tona t'i merrni parasysh gjatë hartimit dhe miratimit të Buxhetit Komunal për vitin 2027, si dhe t'i përfshini ato në procesverbalin e dëgjimit buxhetor të datës 03.08.2026.

Unë, si nxënëse e SHFMU "Lidhja e Pejës", po e paraqesë edhe një kërkesë shtesë dëshirojmë të kërkojmë mbështetjen tuaj për përmirësimin e kushteve në shkollën tonë kërkojmë, që biblioteka e shkollës të pajiset me libra të rinj dhe të larmishëm në mënyrë, që nxënësit të kenë më shumë mundësi për lexim, hulumtim dhe zhvillim, kërkojmë pajisjen e kabineteve me dollape për ruajtjen e mjeteve mësimore veçanërisht për kabinetet e gjeografisë dhe fizikës, duke qenë se në shkollën tonë, po krijohet kabineti i gjeografisë, përfshirë hartën e botës dhe

hartat e tjera mësimore dhe materiale të tjera të nevojshme, po ashtu kërkojmë, që kabineti i kimit të pajiset me substancat dhe materialet bazë të nevojshme për mbajtjen e mësimi dhe besojmë, që realizimi i këtyre kërkesave do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimi dhe do t'ju mundësojnë nxënësve kushte më të mira për të mësuar, si dhe ju falënderojmë për vëmendjen dhe shpresojmë në mbështetjen tuaj. Po ashtu, ju falënderojmë për vëmendjen, gatishmërinë për të dëgjuar zërin e fëmijëve dhe për angazhimin tuaj në ndërtimin e një komuna miqësore për çdo fëmijë.

Fitore Haxhihasani: Jam përfaqësuese e organizatave, që ofrojnë shërbime në nivelin komunal të Pejës, njëkohësisht edhe përfaqësuese e organizatës joqeveritare “Qendra për jetë të pavarur”, që ofron shërbim tërëditor për personat me aftësi të kufizuara mendore parafolësja i përmendi shumë aftësinë e kufizuar, qoftë fizike dhe mendore, që duhet të jetë prioritet sepse janë fëmijë të dikuj edhe duhet të kenë përkujdesje përderisa krejt kjo rini merr shërbime shkollë, kurs, futboll, basketboll kudo, që shkon ajo kategori merr shërbime vetëm në organizatat tana dhe është një fakt shqetësues për ne si organizata, po ka rritje, po na nuk po e shohim atë rritje, si organizata në subvencionim shembull konkret këtë vit shërbimet komunale janë këthi në vlerë monetare, por shuma është përgjysmu, po e marr shembull organizatën, që e menaxhoj unë kam pas vlerë 1000 mijë euro me i prezantu faturat e tash i kam vlerë 500 euro i krymë obligimet deri tash të rrymës tash e tutje me çka me i pagu, çdo ditë e më shumë jemi t’u rreziku me i mbyll këto organizata sinqerisht, po ju them ndoshta me keqardhje se kemi bashkëpunim ndër vite edhe anën tjetër duhet me shiku, që jemi t’u ofru shërbime secila organizatë e ka një numër të madh të përfituesve edhe familjarët janë të gatshëm me i sjellë fëmijët para Komunës, që të bëhet një zgjidhje për këta fëmijë sepse e lëshon punën një punëtorë, e lëshon një psikologe e na po rrezikohemi me mbyllje të organizatave dhe shumica mendojnë, që organizatat kanë paga të mëdhaja jemi me paga ndërminimale vetëm t’u mbijetu mos t’i mbyllim ato dyer e për ata fëmijë pakeqkuptime nëse ndonjëri prej neve këtu ta kishte fëmijën me aftësi të kufizuara e kishim ngrit zërin shumë më shumë. Shpresoj, që t’u fillu nga viti 2027 ta keni si çështje kryesore këtë problem se janë organizata financoni, monitoroni çdo javë, çdo muaj se puna bëhet edhe i shihni rastet, merrni statistikën çka t’ju intereson juve se shumë postime, po shoh, që ka keqpërdorime, por t’i zbulojmë ato, të cilat janë se rastet janë t’u rrit çdo ditë e më shumë, ndërsa sa i përket investimeve kapitale ka vite, që është premtu ndërtimi i objektit të ri për “Qendrën për jetë të pavarur”, shpresojmë që gjatë këtij mandati Kryetari Muhaxheri do ta ketë parasysh dhe do ta përfundoj atë premtim sepse qëndrimi tërëditor nëse nuk pranohen raste të reja rrezikojmë, që një numër të madh të familjeve njëri familjar me lëshu punën për shkak të fëmijës dhe çka po bëjmë, po e rrisim krizën ekonomike brenda familjes se s’ka kush përkujdeset për fëmijën e te na e kanë tërë ditën, pesë ditë të javës edhe për ata punojnë lirshëm burrë e grua.

Drejtoresha Berisha ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre. Dëgjimet buxhetore janë duke vazhduar dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t’u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2027. Drejtoresha Berisha takimin e mbylli në ora 13:00. Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik me OJQ-të, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Klubet Sportive

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 03.08.2026

Ora: 12:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	DETA KRASHI	ZOF-K.K-Peja	(Signature)
2	Fitore Haxhihasani	OJQ, Q. J. P	Haxhihasani
3	Teta Uka	OJQ, Syri i Vizituesit	(Signature)
4	Donika Kelmendi	OJQ "PEMA"	Kelmendi
5	EGZAV QORKANI	HANDIKOS-PE	(Signature)
6	INDRIZ BHEMI	ASD Pejë	(Signature)
7	Sara Camaj	AKF-Peje	Camaj
8	Kanita Shata	AKF-Peje	(Signature)
9	IANA BEQIRI	ROB-	IB.
10	Reon Murgalli	Asamble AKF-Peje	(Signature)
11	Rexho Hasana	Asambleist-AKF-Peje	(Signature)
12	Buna Hasana	Aktiviste e AKF-Peje	(Signature)
13	Flutura Camaj	Aktiviste-AKF-Peje	Camaj
14	SHPRESA LUKA	Q.P.S-U.D. Peje	Shpresa
15	KRESHNIK ARIFI	KLUBI TENISIT Peja	(Signature)
16	FISNIK IMAMI		(Signature)
17	Fatmir Turgut		(Signature)

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Haryste Huxhijet	K. Peje	
19	Diellera Beaulu	K. K. Peje	
20	BERGND TURKIN	K.K. Peje	
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Dëgjimi publik me Bashkësitë Lokale të Qytetit.

Salla e Kuvendit Komunal të Pejës

Dëgjimi ka filluar në ora: 16:00

Datë: 03.08.2026

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 16:00, u mbajt dëgjimi publik me Bashkësitë Lokale të Qytetit.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këtë dëgjim kanë qenë të pranishëm Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtoresha për Administratë në Komunën e Pejës, znj.Nita Panduri Mullarama.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore, siç janë:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49;

Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00;

Shpenzime komunale: 1,157,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00;

Shpenzime kapitale: 14,565,179.51;

Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Xhevat Kajolli: Banoj në rrugën "Gazmend Zajmi". Banorët e kësaj rruge i kanë tri kërkesa. E para është, është kryer pjesërisht: janë futur gypat e ujit, gypi kryesor dhe anësor, por lidhja me orë nuk është bërë. Kërkesa e dytë është shtyllat elektrike, që janë para objekteve, para shtëpive, të zëvendësohen. Kemi qenë në KESCO, te drejtori. Ai na ka thënë se Komuna duhet ta bëjë planin gjeneral për t'i futur në buxhet, pastaj kabllot na i shtrojmë. Kërkesa tjetër është rruga, e cila totalisht është shkatërruar. I kanë futur ato gypat e ujësjetllësit, po ka shumë kalimtarë aty prej Çarshisë së Gjatë te Restaurant Prizreni. Është një rrugicë.

2.Petrit Tigani: Jam nga lagjja "Jarinë", fillimi i rrugës "Shpëtim Bojku". Ne jemi të gjithë banorët e banesës kolektive dhe të gjithë po heqim për një lift. Edhe në hyrjen tonë janë disa invalidë, ku kojshiu Ahmeti është pa dy këmbë. Në katin e pestë është Gëzim Broqi, që 11 vite me pampersa, edhe kojshiu Hasani e ka djalin me sëmundje të keqe. Kemi nevojë urgjente për një lift. Nuk është investim i madh, por na shpëton, se jemi 14 familje, banesa jonë, hyrja A. Ka vend me e vendos liftin dhe të gjithë jemi pajtuar, që nëse ka nevojë të kontribuojmë, kontribuojmë edhe vetë, që të kryhet puna sa më shpejt. Unë vetë jetoj në katin e gjashtë, por fatmirësisht jemi mirë dhe të shëndoshë, por janë edhe një familje me fëmijë të vegjël, të cilët po heqin shumë me ata fëmijë.

3.Skënder Gashi: Do t'i bashkëngjitem kolegut, që ne banojmë në katin e shtatë. E kemi një djalë me sëmundje të rëndë, i cili pa ndihmën tonë s'mundet me lëviz asnjë moment. Nënë e kemi 80 vjeçare dhe i kemi disa kojshi me raste shumë të rënda dhe do të ishte mirë të na

ndihmoni ta qesim këtë lift. Nuk kushton shumë për Komunën, në bazë të ofertave, që i kemi marrë për lifta, dhe shpresojmë të na ndihmoni.

4.Feriz Lukaj: Jam mërgimtar nga Gjermania. Kemi nevojë për ujë. Që tri vjet ujë s'kemi qysh duhet. Unë jam vetë i 10-ti, ndërsa 8 anëtarë mu kthyen për Gjermani, se nuk kanë pasur ujë. Rruga është "Ahmet Rexhaj". Unë ose duhet me e qitë shtëpinë në shitje, që tri vjet s'kam ujë. Kur i kemi pasur gypat më të vjetër, kemi pasur më shumë ujë se që i kemi vendosur gypat e rinj. Kam dhënë kontribut për 35 vjet për këtë vend, për Pejë, për Kosovë, e sot me mbet pa ujë unë. Po ashtu, familja nuk pushuan siç duhet dhe janë kthyer në Gjermani. Kaq! Ju përshëndes!

5.Haki Lajçi: Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam disa kërkesa për Bashkësinë Lokale "Kristali". E kemi problemin me kanalizim në rrugën "Ramë Geci", ku janë mbi 45 shtëpi, pa kanalizim. As shkolla fillore "Smajl Hajdaraj" s'ka. Rruga "Vëllezërit Kastrati", "Gani Daci", që nuk kanë zebra dhe në ato rrugë kalojnë të gjithë nxënësit e shkollës "Smajl Hajdaraj". Rruga "Jeton Dedushaj", e cila është e shkatërruar shumë, ka shumë gropa të mëdha. Ndriçimi është i dobët. Në rrugën "Gani Daci", që t'i kemi policët e shtrirë, janë disa rrugë të paasfaltuara, ndërsa kërkesa është paraqitur. Janë dy rrugë nga 175 metra, të paasfaltuara. Për ndriçim është rruga "Zenel Sylja", janë 27 shtëpi pa ndriçim. Kërkesa është që dy vite, ndriçim nuk kanë. Rruga "Vlora" është e dëmtuar shumë, sepse Hidrodrini e ka dëmtuar në katër vende. Ka edhe kërkesa të tjera, por të gjitha përnjëherë nuk bëhen. Ju faleminderit!

6.Kadri Mavraj: Përshëndetje për të gjithë dhe në veçanti, e falënderoj mërgimtarin z.Feriz Lukaj. Kërkesat, të cilat i parashtroni ky në lokacionin te Fabrika e Tullave, i kam thënë, që janë adresuar, ndërsa Hidrodrini ka punuar në atë drejtim, e ka çuar ujin deri diku, por problemi me pompa dhe nuk është krejt me vajtu, se nuk është gjendja krejt ashtu siç ai mendon. Lokacioni te Fabrika e Tullave, thuaja një pjesë e madhe e banorëve, sidomos në këtë kohë, po kanë vërejtje dhe kërkesa. Hidrodrini, ata i dinë arsyet e veta, pasi janë të ndarë prej Komunës, thotë që i kemi disa reduktime kohë pas kohe.

Unë po ia filloj prej motit të lig, që e patëm kohën e fundit. I ka qitë në shesh shumë gjëra, dhe sa jemi të përgatitur, si banorë dhe si Komunë për me u ba ballë fatkeqësive natyrore. Nga shkurti i 2022, kur patëm erëra të forta, në Bashkësinë tonë Lokale "7 Shtatori", në pjesën verilindore, i kemi pasur bukur disa dëme nga erërat. Kemi dalë me komisione në atë kohë dhe kemi bërë verifikimin individual të familjeve dhe të bizneseve. Nuk kemi pranuar se ishin dëme të mëdha te Maestro, te Berdynajt, te pompat e benzinës. Mirëpo, prej asaj kohe Qeveria nuk ka ndarë asgjë. Po atë vit i patëm të reshurat atmosferike, ku edhe nënë e djalë humbën jetën në lagjen "Asllan Qeshme" dhe ne në Bashkësinë tonë patëm shumë dëme materiale, mirëpo edhe për ato dëme nuk kemi dëmshpërblim.

Tash, në kohën e fundit, në lagjen "Fidanishte", në banesën G2, kemi largim të kulmit. Për fat të mirë, nuk i ka rënë dikujt në kokë dhe me pësu ndonjë qytetar. Pronarët e ndërtesës kanë

marrë iniciativë, që mos me i prit të reshurat e radhës dhe mbetet Komuna me e bë verifikimin e atij dokumentacioni edhe me u përgjegj. Mirëpo, në banesën përballë saj ka lëvizje të kulmit lart dhe deri në dimrin e ardhshëm duhet me kqyr me marrë masa Komuna me i rregullu ato kulme, sepse nuk guxojmë t'i lëmë ashtu.

Pasi jemi në lagjen "Fidanishte", e kemi rastin me shtyllat e ndriçimit, janë të dëmtuara, sikur në rrugën "Myrvete Maksutaj", edhe në rrugën "Konferenca e Bujanit" e deri te Shkolla e Mesme Ekonomike "Ali Hadri". Nuk e di në mëshirën e kujt po mbesin. Ato shtylla janë të dëmtuara në përgjithësi, mirëpo kur do të rregullohen ato, nuk e di?

Një kërkesë, që ka qenë e mëhershme e Komisionit për Emërtim të Rrugëve, e parealizuar në dëgjimin e hershëm dhe kërkesat e kaluara, po më pyesin banorët çka është bërë me riemërtimet e rrugëve, dhe ne do t'i përsërisim prapë.

Kanalizimi i ujërave të zeza, kemi hall me komunitetin jo të ndërgjegjshëm shumë. Janë mbuluar me mbeturina, janë zënë, kanë mbi barishte. Kemi bërë kërkesa, që të bëhet pastrimi i ujërave, i kanaleve të hapura, edhe në lagjen "Fidanishte", edhe në pjesët ku janë të hapura, të lagjes "7 Shtatori". Mirëpo, vetëm ta keni parasysh se kërkesat janë të parashtruara me kohë.

Një kërkesë është për rrugën "Naum Veqilharxhi", në pjesën kah Shehu, deri nalt, atje në shpatije. Kemi infrastrukturë të dëmtuar apo të parregulluar hiç dhe atje ka mbetur me i shiku disa shpronësime, për me ardhë deri te rregullimi i asaj. Edhe ndriçimi, aty ku ka mbetur para pesë viteve, me vazhdu në ato lagje, kish me qenë mirë, sepse i kemi disa rrugë në terr.

Për mirëmbajtje, mos të bëhem shumë i tepërt, se mirëmbajtja e ndriçimit nëpër lagje është shumë në gjendje të mjerueshme. Janë në terr shumë lagje.

7.Shpend Salihaj: Jam Kryetar i Këshillit Lokal Dardania 1 dhe kisha pas dëshirë, që të dija ku ka mbetur puna, edhe pse kam pasur shumë premtime për rrugën "Adrian Krasniqi". Tash, një pjesë e kishin bërë "Dervish Kryeziu", me u asfaltu, trotuari edhe ndriçimi, po ashtu edhe rruga "Sali Çeku". Rrugën, që e lidh rrugën "Adrian Krasniqi" me Qendrën e Mjekësisë Familjare është premtuar të rregullohet trotuari. Asnjë nga punët nuk janë përfunduar, edhe pse janë premtuar shumë herë. Kisha pasur dëshirë të dija ku kanë ngecur punët. Ju faleminderit!

8.Valbona Avdija: Jam Kryetarja e Bashkësisë Lokale "2 Korriku". Përshëndetje për të gjithë. Unë kisha dashur fillimisht ta falënderoj Komunën për të gjithë kontributin dhe për të gjitha punët e bëra në Bashkësinë Lokale tonë, ku janë realizuar shumë punë dhe projekte të rëndësishme. Mund të them me bindje të plotë, që rreth 80 për qind të punëve janë

përfunduar në lagjen tonë, përfshirë rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, asfaltimin e rrugëve, rregullimin e kanalit të Çokolicës, ndërtimin e mureve mbrojtëse, urave dhe ndriçimit publik në tërësi, përveç në një pjesë të rrugës lart, ku duhet të vendosen edhe tri shtylla dhe të përfundohet komplet.

Megjithatë, çdo ditë kemi kërkesa të reja. Do të thotë, këto investime, që janë bërë te ne e kanë rregulluar jetën e banorëve, e kanë rritur sigurinë dhe e kanë zvogëluar me anë të kanalit, që është rregulluar, rrezikun e vërshimeve. Siç e dini "2 Korriku", ka qenë pjesa më e dëmtuar gjatë kohës së vërshimeve. Në atë kohë, edhe njëherë ju falënderoj për zemërsisht në emër të banorëve.

Një kërkesë që e kemi bërë është edhe te marketi "Buna", ku ndahen dy rrugët e "Asllan Çeshmës", ku kanë mbetur vetëm disa anekse të rrugëve, të vogla, 50 deri në 100 metra. Te pjesa lart e "Azem Bejtës" është një rrugë, që është 110 metra, por ajo rrugë, kur është shtruar rruga "Mbreti Bardhyl", që ka përfunduar, ajo rrugë ka mbetur, se është e kubëzuar. Janë prishur kubëzat dhe duhet të asfaltohet tash për t'u lidhur, por edhe ujësjellësi nuk është në gjendje të mirë.

Pastaj, rruga "Sami Peja", 50 metra, 100 metra "Ramiz Xhema", edhe një rrugë "Beteja e Albulenës", janë rrugë të vogla për t'u asfaltuar dhe në bazë të kërkesave, me buxhetin e ri na kanë thënë se do të kryhen.

Kërkesa tjetër është rruga që është te marketi "Buna", te rruga "Azem Bejta". Kam kërkesë, prej banorëve për kanalin, që është përfunduar, që është me thellësi shumë të madhe. Bazamenti i kanalit, një pjesë është me gropa edhe me gurë dhe është me rrezik për banorët, se i kemi pasur tri aksidente. Edhe një kërkesë e kemi bërë më herët për t'u vendosur anësoret e kanalit, pasi tri raste i kemi, që po bien në kanal dhe ka të lënduar. Hera e fundit është para dy javëve, si në rrugën "Azem Bejta", edhe në rrugën "Asllan Çeshme". Fëmija me biçikletë, rasti i fundit, ka përfunduar me dy unaza të thyera dhe me gips në këmbë, ende është i shtrirë. Do të thotë, kanali është shumë i thellë dhe është thelluar për shkak të ujit të madh.

Banorët, po kërkojnë gjithashtu prej Komunës së Pejës, mundësisht, të ketë një bashkëpunim me KEDS-in, për arsye se nuk po vijnë t'i rregullojnë shtyllat e ndriçimit publik. Janë diku 4 ose 5 shtylla dhe është shumë rrezik për banorët. Ju faleminderit shumë për të gjithë punën e bërë!

9. Bejhan Krasniqi: Jam Kryetar i Bashkësisë Lokale "Karagaqi". Përshëndetje për të gjithë. E kam një kërkesë, prej banorëve të Karagaqit për me u ndërtu një palë shkallë në mes të Postës Numër Pesë dhe Fontanës për me mujt me u ngjit në park lart. Këtë na e kanë premtuar edhe më herët, por shpresojmë që në të ardhmen të kryhet edhe kjo punë. Ju faleminderit!

10.Ardi Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam dy rekomandime dhe një kërkesë, duke iu bashkëngjitur asaj, që e tha Valbona Avdijsa pak më herët në lagjen "2 Korriku".

Lidhur me kërkesën është sa për informacion, se kur pritet të përfundohet kanali i Çokolicës, që ka mbetur segmenti prej kthesës të "Jarina" e deri te ish-Çakorri, se pas asaj pritet të përfundojë edhe asfaltimi i asaj rruge. Edhe si kërkesë tjetër, edhe rekomandim, është në rrugën "Bege Maliqi". Janë të rrënuara dy shtëpi, i ka rrënuar Komuna, për shkak të përmbajtjeve të mëhershme. Është duke u bërë rregullimi i kanalit, po tash, me ato dy parcela aty, rekomandimi është që njëra nga parcelat të kthehet në park për fëmijë, se qysh e tha edhe Valbona, fëmijët janë rrënuar në kanal, se nuk kanë vend ku të luajnë fëmijët. Si opsion i dytë për parcelën e dytë është të ndërtohet Shtëpia e Komunitetit, se duke e marrë parasysh se Bashkësia Lokale "2 Korriku" është goxha e madhe, nuk e ka asnjë Shtëpi të Komunitetit, asnjë hapësirë, ku fëmijët mund të kalojnë kohën e tyre, përveç SHFMU "Asdreni", ku në shumicën e rasteve është e mbyllur për shkak të angazhimeve të tyre. Ju faleminderit!

11.Jakup Lajçi: Jam Kryetar i Bashkësisë Lokale "Dardania 2". Përshëndetje për të gjithë. I kam disa kërkesa: ndriçim, kanalizim dhe asfalt. Asfaltimi i rrugës "Nurie Zeka", 400 metra; rrugës "Valon Shala", që e lidh "Dardaninë 2 dhe 3" dhe Loxhën e Raushiqin, ajo lidh 450 metra; në rrugën "Rexhë Avdijsa", me gjatësi 700 metra. Ju faleminderit!

12.Granit Thaqi: Ju përshëndes të gjithëve e kam një kërkesë për rrugën "Hasan Riza", për shkak të dëmtimit të rrugës nga ujësjellësi rruga është bërë e pakalueshme dhe kërkoj nga ju, që ta keni parasysh kërkesën dhe ta shtroni një shtresë të asfaltit.

Nënkryetari Asllani ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre. Dëgjimet buxhetore janë duke vazhduar dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2027. Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 17:30.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik me OJQ-të, Qyteti - të gjitha bashkësitë lokale

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 03.08.2026

Ora: 16:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	DADINA DRAGAI	KK - Peje	
2	Gentiana Begjani Atashi	KK Peje	
3	SHPEKLE SALIHAD	K.K. PEJE	
4	JAKUP LAJCI	DARDANIA	
5	KARIM MAMUQI	K.C.F. SAKAR	
6	Nexhat Mirodi	B.T. "M. KADA"	
7	HEKHAHILAJCI	D. KRISTAL	
8	SHKUFET LAJCI	B.T. 2 KORRIKU	
9	VALBONA AVDIJANI	B.T. 2 KORRIKU	
10	BEJHAN KRASNIQ	K.B.L. KARAGJOS	
11	IVAN PAVATA	PAVAT KULT.	
12	Feriz Lika	Ahmet Lika	
13	Xhevat Kojoll		
14	ARDI GASHI	2-KORRIKU	
15	FISNIK IMAMI	LIC P.5.75	
16	Kastriot Delegu	Komuna e Pejes	

17			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	GEN TIAN SITH LA	POK SIFENDISI	G. Sifendi
19	ALBION KERGUDI	PETE	
20	PETIT TIGANI	JARIN	
21	Uthmanet Alunet	JARIN	
22	Azellan Gashi	JARIN	B. Gashi
23	Egton HASTALI	Dardania 2	
24	Shahna Muhametane	OSCE	Shahna Muhametane
25	SHIROSA LUKA	Q.V.S	
26	HAKIRO HAKHJAZ	K.K	Hakiro Hakhjaz
27	Sulvan RASH	K. L. KAPESHANIC	
28	DR. LTA KASHNICO	K.K. Ryo	
29	Fatim Tuguni	DBF	
30	Didlles Beusha	DBF	
31	Fabrizio Allani	K. Pesho	
32	Nita Canchri - Mullarano	- II -	
33	Gazran Tura	- II -	
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Rugovës.

Salla e Kuvendit Komunal të Pejës

Dëgjimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 03.08.2026

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 18:00, u mbajt dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Rugovës.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këtë dëgjim kanë qenë të pranishëm Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Drejtori për Punë Komunale dhe Shërbime Publike në Komunën e Pejës, z.Agron Nikçi, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtoresha për Administratë në Komunën e Pejës, znj.Nita Panduri Mullarama, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore, siç janë:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49;

Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00;

Shpenzime komunale: 1,157,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00;

Shpenzime kapitale: 14,565,179.51;

Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani, po e kaloj fjalën te ju, por së pari prezentohuni dhe e hapim diskutimin.

1.Mustafë Lajçi: Jam Kryetar i Nëndegës Rugova 1, që i përfshin 11 fshatra. Përshëndetje për të gjithë. Duke u nisur në parim, që në Bellopaq akoma nuk ka rrugë, është hapur një vijë deri në Llaz, por është ndërprerë. Në takimin, të cilin e kam bërë me Kryetarin e Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, i cili ka thënë, që do të shtrohet asfalt, por nuk po ndodh. Çka fshihet, kush ka interes, ne nuk e dimë, por jemi të diskriminuar. Pas bisedës me Drejtorin e Drejtorisë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçi, i cili më tha që do të fillojë, por prapë asgjë. Ndërsa nuk e di kush ka interes dhe kush qëndron pas kësaj pune? Ju faleminderit!

2.Enver Lajçi: Unë jam i fshatit Drelaj. Fshati Drelaj ndahet në dy pjesë. Unë ju përshëndes të gjithëve, por në veçanti Kryetarin Muhaxheri, i cili nuk ndodhet këtu për momentin, si dhe z.Agron Nikçi. Sa i përket fshatit Drelaj, kanë përfunduar asfaltimet dhe është bërë një punë e mirë. Sa i përket pjesës së Liqenatit i kemi 12 km. Në vitin 2020, Kuvendi Komunal i Pejës, në krye me Gazmend Muhaxherin, na i kanë pranuar 5 km për t'i bërë asfalt dhe i morën dy kompani. Kanë punuar mirë, por filloi lufta në Ukrainë dhe u bënë shtrenjtimet e mëdha, në veçanti nafta. Një kohë shkoj me neglizhencë, por drejtori për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçi me iniciativë të tij, me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, e shpallën

tenderin dhe janë duke e bërë një punë shumë të mirë. Tash kanë mbetur edhe 2 km e gjysmë dhe është duke u bërë asfalti shumë i mirë. E falënderojmë punëkryesin, por edhe organet, të cilat kanë punuar në këtë drejtim. Por, ne i kemi edhe 6 km, për të cilat i kemi bërë disa kërkesa për rrugë, ju e dini. Por, rast specifik dhe shumë i veçantë jemi me ujë. Ujin e pijes e kemi problem. Na te Leqinatit i kemi tri burime atje, që dalin në një vend. Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj është i njoftuar dhe aty është uji, që e furnizon të gjithë Leqinatit. E kemi projektin, që pesë vjet dhe e kemi dorëzuar.

Ju bëjmë apel të gjithëve, që të na e merrni parasysh kërkesën tonë, sepse nëse e merrni parasysh këtë vit, atëherë për vitin e ardhshëm ne nuk do të kemi problem me ujë dhe do të furnizohemi të gjithë. Ju faleminderit!

3.Nezir Iberdemaj: Jam Kryetar i fshatit Shtupeq i Vogël. Krejt Rugova e di, që Shtupeqi i Vogël ka shumë halle dhe më erdhi mirë, që Enveri, parafolësi, tha që në Drelaj i keni bërë 5 km, se edhe ne kemi pasur kërkesa të ndryshme. Ju që jeni atje, Kryesues i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj dhe Drejtori për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçi, e dini shumë mirë, që e kemi marrë një pëlqim të mjedisit për ujësjellës.

Edhe neve na është premtuar, që do të futet këtë vit në projekt. Ne atë pëlqim e kemi për dy vjet. Nëse nuk hyn ai projekt, dy vjet, që kemi vrapuar pas dokumentacionit shkojnë huq. Është një projekt, që nuk pengohet prej Ministrisë, se e kemi dokumentin e tyre. Ju kisha lutur, që të jetë prioritarë, të mbahemi për fjalën, që e kemi thënë.

Pastaj, i kemi problemet e rrugës. Për këtë vit është premtuar, që do të bëhet diçka, por nuk po shoh, që është duke u bërë diçka. Është premtuar një unazë në fshat të bëhet, gati shkoi vera dhe nuk filloi asgjë. Kishim pasur qejf t'i dinim arsyet. Kur firma e ka tenderin, çka është në pyetje? A do të qetë dorë Komuna e Pejës në fshatin tonë ndonjë ditë, të shihet diçka?

Unë e kam këtu edhe Isuf Lajçin. Ky është më shumë nëpër Pejë, e nëpër Rugovë se unë. Unë e di, që është edhe një projekt për Bujoviç, por unë kam kërkesë, sidomos në fshat, në Shtupeq të Vogël, të intervenohet me projektin e ujit edhe me atë çka është premtuar të kryhet këtë vit.

Për vitin e ardhshëm kërkoj prej atje ku është gurra, te Qeshmja, që i thojmë na, edhe teposhtë fshatit të vijë me asfalt, sikur nëpër fshatrat tjera. Sa për këtë rrugën e Peklenës, ne kemi hequr dorë si fshat. E dimë, që janë bërë disa vite, që nuk po realizohet. Po hidhet faji herë te Ministria e herë te Komuna. Prandaj, po kërkojmë të intervenohet në fshat, si në çdo

fshat tjetër të Rugovës, të kryhet edhe te ne rruga me asfalt për vitin e ardhshëm! Ju faleminderit!

4.Xhevat Osmanaj: Jam nga Kuqishta. Përshëndetje për të gjithë. E kemi dorëzuar një projekt për ndërtimin e rezervuarit, i cili ka kaluar në projekt-buxhet për vitin 2026. Kam biseduar me Kryetarin dhe Drejtorin, por nuk e di a do të bëhet këtë vit apo vitin tjetër, ku kanë ngecur punët, nuk e di? Por, Drejtori na ka premtu, që këtë vit do të bëhet për lagjen "Gjevukaj".

5.Jusuf Lajçi: Vij nga fshati Shtupeq i Vogël, por me banim jam në rrethin e Pejës, për shkak të infrastrukturës, se s'kemi mundur ta shfrytëzojmë fshatin asnjë pikë. Është shumë e vërtetë, që fshati Shtupeq i Vogël është humnerë e madhe. Kam folur disa herë dhe deri më tani nuk është intervenuar asgjë.

Pak jam i njoftuar, që ajo rruga e fshatit ka filluar diçka dhe është një ringjallje e madhe për ne. Jam në kontakt direkt me Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, por edhe me Drejtorin për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, z.Agron Nikçi.

Janë premtuar gjërat dhe besoj, që këtë vit do të bëhet diçka, sepse nuk di çka të kërkoj më përpara, sepse çdo gjë është me prioritet.

Sa i përket këtij viti, unë po e falënderoj këtë udhëheqësi të Pejës. Po e shoh, që kanë vendosur me vepru në Shtupeq të Vogël dhe të ndihet dora e shtetit në fshatin tonë.

Në fshatin tonë ka njerëz, që merren me blegtori, që kanë dele mbi 500 copë, e kanë lopë 30 copë. Me ju thënë të vërtetën, goxha me vështirësi janë duke e mbajtur bjeshkën, sepse edhe ato rrugët ekzistuese, që janë nuk janë mirë të kalueshme. Po ashtu, kemi problem me një përrua, sepse kur ka reshje aty bëhet rruga e pakalueshme. Dhe besoj që këtë vit, na Shtupeqi i Vogël, do të jemi të kënaqur. Ju faleminderit, që më dëgjuat. Respekt për Kryetarin e fshatit, z.Nezir Iberdemaj. Respekt për punën tuaj, çka keni vepru dhe çka keni premtu.

6.Fazli Muriqi: Jam prej Rugovës, kemi vendosur për ta ngritur një shtatore të një luftëtari të Rugovës. Fjala është për Sak Faslinë. Edhe Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri është i njoftuar. Vendin na e kanë lejuar, është bërë projekti dhe shuma e projektit është 55 mijë euro. Shumën, rreth 70 për qind, e kemi mbledhur. Ne, si këshill organizativ e bëjmë një kërkesë për ndihmë, sado që mund të na ndihmoni, si Komunë lidhur me këtë projekt.

Për të folur për historinë e Sak Faslisë s'ka nevojë, se figura e tij njihet. Tërë jetën e ka kaluar

në luftë. Kanë shkruar gazetat, kanë folur mediat dhe shpresoj, që do të na ndihmoni për realizimin e këtij projekti. Ju faleminderit!

7.Xhevdet Gorani: Ju përshëndes të gjithëve. Pasi, parafolësi Enveri i tha pothuajse të gjitha, po edhe unë diçka, po shtoj. Problemin kryesor e kemi me rrugë. E kanë bërë me zhavorr gati krejt, por asfalt nuk e di pse nuk e kanë bërë.

Por edhe problemi me ujë. Ujë kemi pasur derisa nuk është nisur rruga. I prishën gypat. Si filluan me rregullu rrugën, janë tri burime dhe me pas mundësi me i bashku dhe ta bëjmë një pishinë të madhe dhe do të ketë ujë për të gjithë. Kaq! Ju faleminderit!

Nënkryetari Asllani ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Dëgjimet buxhetore janë duke vazhduar dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2027. Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:30.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ




Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik me ~~OIQ~~-të, Fshatrat e Rugovës

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Data: 03.08.2026

Ora: 18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Haxhi Krasniqi		
2	Musliu Gorani		
3	Gjeli Zogji		
4	Abdullahu		
5	Xhevat Osmani		
6	Gjeli Musiqi		
7	Mustafa Zogji		
8	Ramë Hajri		
9	Isuf Lajçi	Sh. Vagot	
10	Jeton Lajçi	sh. Vagot	
11	Gjeli Lajçi	Sh. Vagot	
12	Nezir Berdani	sh. Vagot	
13	Fatmir Jusu	DBE	
14	Nita Pandu	K.K. Rye	
15	Duthe Krasniqi	KK Rye	
16	Kasmiot Belegu	KK Rye	
17	Hopite Hoxhi	K.K. Rye	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Agdon Nikçi		
19	FETRA BËRLAZOLLI	L. V. POJË	
20	SHIKESA LUKA	O. P. S	
21	GABRIEL TUN	K. P. S	
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Me banorët e fshatrave Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë, Ozdrim, Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.

Sot, më 04.08.2026, në ora 18:00, kanë filluar dëgjimet buxhetore me banorët e fshatrave Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë, Ozdrim, Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këtë dëgjim kanë qenë të pranishëm Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Nënkryetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović dhe Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore, siç janë:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49;

Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00;

Shpenzime komunale: 1,157,240.00;

Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00;

Shpenzime kapitale: 14,565,179.51;

Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Qerim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Kam gjashtë kërkesa:

Vitomirica nuk ka kanalizim, përveç një pjese shumë të vogël.

Çerdhja, e cila është mbyllur për shkak të problemeve me energjinë elektrike, a do të rikthehet dhe a do të funksionojë tash e tutje?

Kemi probleme me qentë endacakë në Vitomiricë, sidomos në rrugën "Sokol Nikqi".

Stacioni policor është i gatshëm dhe së shpejti pritet të lëshohet në funksion.

Ndriçimi publik duhet të rritet.

Rrugët tranzit në Vitomiricë janë tepër të ngarkuara dhe të dëmtuara, prandaj duhet të riasfaltohen.

2.Safet Diplarin: Përshëndetje për të gjithë. Kam probleme me regjistrimin e shtëpisë.

3.Naser Thaqi: Përshëndetje për të gjithë. Në një gjatësi prej 600 metrash, ujësjellësi e ka dëmtuar rrugën "Afrim Hoti" në 18 vende.

4.Meris Palamar: Përshëndetje për të gjithë. Kemi probleme me mbeturinat. Rrugët janë të mbushura me mbeturina, po ashtu edhe trotuaret. Mungon mirëmbajtja dhe duhet të largohen mbeturinat nga trotuaret.

5.Dafina Draga: Përshëndetje për të gjithë. Prioritet e kemi kanalizimin, asfaltimin e rrugëve dhe rregullimin e trotuareve, si dhe riemërtimin e rrugëve.

6.Burim Mustafaj: Ndriçimi i rrugës në një gjatësi prej 600 metrash, nga trafostacioni elektrik deri te lagjja Baliçukt.

7.Jeton Dreshaj: Ndriçimi i rrugës "Ukë Dreshaj".

8.Sefer Husaj: Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit nga lokali "Nikis Bar" deri te xhamia.

9.Fitim Dreshaj: Rregullimi i ujërave të zeza dhe kanalizimit, si dhe vendosja e rrethojës së urës nga Nikqt deri te lagjja "Iberdemaj".

Kërkesa të tjera: Trotuari nga lokali "Nikis Bar" deri te shkolla, si dhe pastrimi i mbeturinave te varrezat e reja dhe në ledinën në fshatin Nabërgjan.

Takimet për dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:40.

Procesmbajtësja: Arianë Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik për fshatrat Trestenik,
Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.**

Vendi: **Shkolla fillore në Nabërgjan**

Data: **04.08.2026**

Ora: **16:30**

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	SEFER HUSAJ		
2	Benok Husaj		
3	Istret Husaj		
4	Adem Rali		
5	YLL HUSAJ		
6	JASHAR HUSAJ		
7	DRITON HUSAJ		
8	ADULLA DAGE		
9	Reinë Shalaj		
10	Secnider Husaj		
11	ALI HUSAJ		
12	Asrolit Husaj		
13	Berrik Berbat		
14	Kretënik - V		
15	Kretënik Berbat		
16	BUDAR BERBATI		
17	Fajmir BERBATI		

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	FITIM DRESHAJ		<i>[Signature]</i>
19	ISTREF DRESHAJ		<i>[Signature]</i>
20	Jeton Dreshaj		<i>[Signature]</i>
21	RIZA Z. DRESHAJ		<i>[Signature]</i>
22	GERIM KOSTAJ		<i>[Signature]</i>
23	BULEN KASHTANI		<i>[Signature]</i>
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik për fshatrat Vitomiricë,
Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim.

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal - QENDRA RINDRORJE NE VITOMIRICE

Data: 04.08.2026

Ora: 18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Sotet Diftari	Syri Vitomirice	D. Lajç
2	QORIM KRISTO	K. Brestovik	Q. Kristo
3	SHKEMISIN PROVA	DUBOVË	Shkemisin Prova
4	DAFINA DRAGAJ	Katundi i Ri	D. Dragaj
5	FAIK ZEBRAJ	Katundi i Ri	F. Zebraj
6	MUAMEL DUBOVË	VITOMIRICA	M. Dubovë
7	Vilbena Belyu	OSCE	V. Belyu
8	DARLIJANIN NUSRET		D. Nusret
9	Deqbanin Diftari		D. Diftari
10	Besim Arçagaj	KAT. I Ri	B. Arçagaj
11	DETA KRISTO	K. K. Pejë	D. Kristo
12	IZET KOSIĆ	M.H. Zeto. R. R. R.	I. Kosić
13	Aljrim Shala	Vitominicë	A. Shala
14	Fatmir Jurgu	DBI	F. Jurgu
15	Mexis Palamar	Vitominicë	M. Palamar
16	Almin Palamar	Vitominica	A.P.
17	BESIM DALLI	VITOMIRICË	B. Dalli

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	Armand Dërraj	Vitomarie	dërraj
19	Harap Dërraj	Vitmiri	Harap
20	Ardi Daci	Vitmiri	Ardi
21	Hajro Haxhiu	Haxhiu	Haxhiu
22	Shpresa Leka	Q.P.S	Shpresa
23	Gazmend Turku	K.P.S	Gazmend
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – DËGJIMI BUXHETOR ME BANORËT E FSHATRAVE TË PODGURIT

Më 05.08.2026, në SHFMU "Lidhja e Pejës", në Novosellë, në ora 17:30 ka filluar dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave të Podgurit për projekt-buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Qëllimi i dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këtë dëgjim kanë qenë të pranishëm Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Shefi i Kabinetit, z.Faik Zekaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtori për Çështje Pronësore-Juridike, z.Arianit Krasniqi.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore, siç janë:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49, mallra dhe shërbime: 4,985,490.00, shpenzime komunale: 1,157,240.00, subvencione dhe transfere: 1,930,626.00, si dhe shpenzime kapitale 14,565,179.51.

Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Imer Mujaj: Përshëndetje për të gjithë. Ne, Kryesia e fshatit Jabllanicë e Vogël, në emër të banorëve të këtij fshati, kërkojmë që të intervenohet në realizimin e prioriteteve të mëposhtme, të cilat janë të një rëndësie dhe urgjence të veçantë për banorët e fshatit Jabllanicë e Vogël, Komuna e Pejës:

1.Asfaltimi i rrugëve të mbetura pa u asfaltuar:

Kërkojmë asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave pranë shtëpive, të cilat janë të domosdoshme për qarkullimin e banorëve:

"Isa H. Mavraj" – 22 m
"Kadri Sh. Rexhaj" – 35 m
"Fisnik R. Elezaj" – 25 m
"Visar R. Elezaj" – 20 m
"Alberim U. Mujaj" – 15 m
"Esat M. Mujaj" – 20 m
"Valbona Fatmir Blakaj" – 50 m
"Rexhë Tahir Mujaj" – 30 m
"Liridon A. Blakaj" – 300 m
"Shefki M. Blakaj" – 100 m
"Halit R. Mujaj" – 40 m
"Zenun B. Mujaj" – 20 m.

Gjithashtu, kërkojmë:

Asfaltimin e rrugës nga qendra e fshatit në drejtim të Varidolit, e cila lidhet me rrugën kryesore Pejë–Istog, me gjatësi rreth 800 m.

Asfaltimin e qendrës dhe sheshit të fshatit, në afërsi të Shtëpisë së Kulturës, në sipërfaqe

20 m × 15 m, si dhe punimin dhe betonimin e një ure mbi përrua, me gjatësi rreth 15 m.
Rregullimin e sheshit të vogël në hyrje të fshatit, përmes kubëzimit ose asfaltimit.
Rregullimin e rrugëve fushore, ku parashihet mbushja me zhavorr të trashë.
Rregullimin e rrugës së Jesenave të Epërme – 800 m.
Rregullimin e rrugës së Jesenave të Poshtme – 300 m.
Rregullimin e rrugës së Nenonpolave – 900 m.
Rregullimin e rrugës së Trojeve – 2,000 m.

2.Kanalet për ujitje:

Kërkojmë rregullimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve për ujitje:

Kanali përgjatë oborrit të shkollës – 200 m

Kanali i Nenopolave – 600 m

Kanali i Arave të Thana – 400 m

Kanali i Trojeve – 800 m

Kanali i Livadheve të Shatrit – 400 m.

3.Muret mbrojtëse dhe trotualet:

Kërkojmë ndërtimin dhe rregullimin e mureve mbrojtëse përgjatë rrugëve:

Rruga e Gurinave – 50 m

Përfundimi i murit të trotuarit përgjatë rrugës së fshatit – 25 m

Ndërtimi i murit të shkollës dhe i trotuarit përgjatë këtij muri.

4.Ndriçimi publik:

Kërkojmë vendosjen dhe përmirësimin e ndriçimit publik në rrugët sekondare të fshatit.

Shpresojmë dhe besojmë se këto kërkesa, të cilat sipas vlerësimit tonë janë të arsyeshme dhe në interes të drejtpërdrejtë të banorëve të fshatit, do të shqyrtohen me prioritet dhe do të realizohen.

2.Donjeta Bërdynaj: Përshëndetje për të gjithë në emër të lagjes "Bërdynaj" kërkojmë vazhdimin e asfaltimit të rrugës "Sahit Bërdyna" rreth 400 metra, për t'u lidhur me rrugën "Sokol Salihu".

3.Naim Tahiri: Përshëndetje kërkesat tona për fshatin Novosellë janë: kanalizimi për ujërat e zeza, rruga Novosellë – Shtedim, Jabllanicë e Vogë, pastrami I Drinit të Bardhë nga ujërat e zeza, rregullimi I rrugës Novosellë-Dubovë e Madhe, riparimi I shtëpisë së lagjes,

Mirëmbajtja e Kodrës së Dëshmorëve, varrezave, rrethojave, pra mirëmbajtja për këto hapësira.

4.Xhevdet Ahmetaj: Përshëndetje për të gjithë kërkesat e fshatrave Lipë, Brestovikë, Cigë dhe Dushkajë janë: asfaltimi i rrugës "Sylë Hasani", në Brestovikë 1,5 km, rregullimi i rrugës dhe Rusoli, 5 km, asfaltimi i rrugës në lagjen "Vadogjive" në Lipë 500 metra, asfaltimi i rrugës për Pllanë të Lipës 2,5 km, asfaltimi i rrugës në lagjen "Mustafaj" 200 metra, ndërtimi i rezervuarit të ujit të pijes në Vrella të Lipës dhe shpërndarja e rrjetit të ujit rezervuari 40-50 m3, rrjeti 5 km, asfaltimi i rrugës për Lipë të Vogël, Brestovikë-Lipë e Vogël, me gjatësi 5-6 km, si dhe mirëmbajtja e rrugës Lipë-Novosellë.

5.Nexhmedin Xhuraj, nga fshati Radavc: Kërkesën e kemi për kanalizim dhe rrugën Shtedim.

6.Isat Ferizaj, nga fshati Jabllanicë e Madhe: Kemi problem me ujin e pijes dhe me kanalizimin; është tmerr i madh. Kërkesë kemi edhe për rrugën për bjeshkë, si dhe te Shtëpia e Kulturës, për një fushë të volejbollit ose të basketbollit.

7.Nehat Bajraktari: Një ndër projektet më prioritare për rajonin tonë, po flas për Radavcin dhe Jabllanicën e Madhe, është përroi që vjen prej Jabllanicës së Madhe dhe kalon nëpër Radavc, ku po mblidhen ujërat e zeza. Vozitja nëpër fshat është duke u bërë tepër e rrezikshme. Kërkojmë dy policë të shtrirë prej betoni. Sa i përket bujqësisë në rajonin tonë, nuk ka toka për makineri të mëdha; mundësisht të sigurohen makineri të vogla, të cilat nevojiten për pemishte, dredhëza, mjedra dhe boronica.

8.Halil Elezaj: Çka po ndodh me sallën e edukatës fizike, kur dihet që në shtator ka me fillu mësimi? Pastaj, një gyp e kemi blerë vetë dhe e kemi vendosur me një grup vullnetarësh te përroi. Kanalizimi është i vjetruar. Shumë njerëz merren me bujqësi dhe, nëse do të kishin siguri të ujit, do të merreshin edhe më shumë. Rruga Radavc-Jabllanicë e Madhe duhet të riparohet këtë vit. Pastaj, edhe rrugët e bjeshkës, sepse do të rritej numri i njerëzve që i mbajnë kafshët, si dhe vazhdimi i trotuarit deri në Novosellë.

9.Sylë Peli: I kemi 100 metra rrugë që duhet të asfaltohen, por pengesë kryesore është kanali i ujitjes që vjen prej Drinit deri te bazeni. Varrezat e fshatit kanë nevojë të rrethohen komplet. Ndërsa, sa i përket kërkesave të tjera, janë realizuar komplet.

10.Shkumbin Pelaj, nga Novosella: Problem me ujin e pijes nuk kemi. Kemi edhe një rrugë të paasfaltuar, rreth 100 metra.

Nënkryetari I Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Takimet për dëgjimet buxhetore do të vazhdojnë dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj

1. Diellera Berusha	K. K. Pejë	Berusha
2. DEITA KRASHIOTI	K. K. Pejë	Dejda
3. SHPRESA LUKAS	Q. P. S	ShkZ
4. SYLË PELI	NOVOSELLË	Gjiljeli
5. MER MUJAJ	7. EVOGEL	Shkup
6. BESNIK SEFAT	NOVOSELLË	Bep
7. Armi MEUNAJ		Armi
8. SAT FERIBAJ	JABLLANIC EM.	Shkup
9. Naimi Dërrin	Novosello	Novosello
10. SAKOMBIN PCLAY	NOVOSELLË	Shkup
11. Nexhmedin Xhung	RADAC	Shkup
12. NERAT BASHKALARI	RADAC	Shkup
13. FAIK ZERAJ	KIL PESJE	Shkup
14. Arifait KRASHIOTI		Shkup
15. DONJETA BERDYNAT	NOVOSELLË	Shkup
16. GABRIEL TUKU	BEG	A

PODGUR 17:30
5.08.2026

16.eto 7 17
1 12



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

PROCESVERBAL

NGA DËGJIMI PUBLIK PËR PROPOZIM-BUXHETIN E VITIT 2027 NË FSHATIN GORAZHDEC

Data: 05.08.2026

Vendi: Gorazhdec

Tema: Dëgjimi publik me qytetarët lidhur me planifikimin e kërkesave dhe prioritetëve për Propozim-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Më datë **05.08.2026**, në fshatin **Gorazhdec**, është mbajtur dëgjimi publik me banorët e këtij lokaliteti, në kuadër të procesit të konsultimeve publike për hartimin e **Propozim-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027**.

Qëllimi i këtij takimi ishte t'u mundësohej banorëve paraqitja e kërkesave, nevojave dhe prioritetëve të tyre, me qëllim që ato të evidentohen, shqyrtohen dhe, në përputhje me prioritetet e përcaktuara dhe mundësitë buxhetore të Komunës, të merren parasysh gjatë procesit të planifikimit buxhetor.

Gjatë diskutimit, banorët paraqitën një numër kërkesash që lidhen kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës publike, sigurinë në komunikacion, mirëmbajtjen dhe rregullimin e hapësirave publike, mbështetjen e bujqësisë, infrastrukturën e ujitjes, trajtimin e çështjeve të sigurisë dhe përmirësimin e objekteve me karakter kulturor.

KËRKESAT E PARAQITURA NGA BANORËT

Gjatë dëgjimit publik, banorët pjesëmarrës paraqitën kërkesat dhe shqetësimet e tyre lidhur me nevojat prioritare të fshatit Gorazhdec. Kërkesat e paraqitura janë evidentuar në këtë procesverbal dhe do të përcillen për shqyrtim dhe trajtim të mëtejshëm nga drejtoritë dhe strukturat kompetente të Komunës së Pejës, në përputhje me kompetencat, prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

1. Mijo Dakić

Banori **Mijo Dakić** paraqiti kërkesa që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës dhe hapësirave publike në fshatin Gorazhdec.

Kërkesat e paraqitura janë:

Përmirësimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në zonat ku mungon ndriçimi ose ku ekziston nevoja për intervenime shtesë;

Rregullimi i parkut dhe krijimi i një hapësire për lojëra për fëmijë, me qëllim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për rekreacion;

Rrethimi i varrezave në Gorazhdec, me qëllim të rregullimit dhe mirëmbajtjes së kësaj hapësire.

2. Luka Zlatićanin

Banori **Luka Zlatićanin** paraqiti kërkesa, që lidhen me sigurinë në komunikacion dhe mbështetjen e sektorit të bujqësisë.

Kërkesat e paraqitura janë:

Vendosja e pengesave për ngadalësimin e automjeteve, përkatësisht “**policëve të shtrirë**”, pranë shkollës, me qëllim të rritjes së sigurisë së nxënësve, këmbësorëve dhe banorëve;

Mbështetja për sigurimin e traktorëve apo makinerisë bujqësore, me qëllim të lehtësimit të punës së fermerëve dhe zhvillimit të veprimtarisë bujqësore.

3. Dragan Vukunević

Banori **Dragan Vukunević** paraqiti kërkesën për:

Rregullimin ose ndërtimin e kanalit të ujitjes në një gjatësi prej rreth **200 metrash**, duke theksuar nevojën për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e bujqësisë.

4. Saša Petrović

Banori **Saša Petrović** ngriti çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe sigurinë e banorëve të lokalitetit, përkatësisht:

Rregullimin dhe trajtimin e çështjes së digës, përkatësisht vlerësimin e gjendjes së saj dhe nevojës për intervenime të mundshme;

Trajtimin e problemit të qenve endacakë, të cilët paraqesin shqetësim për sigurinë dhe mirëqenien e banorëve.

5. Darko Dimitrijević

Banori **Darko Dimitrijević** paraqiti kërkesën për:

Renovimin dhe rregullimin e **Shtëpisë së Kulturës në Gorazhdec**, me qëllim të përmirësimit të kushteve të objektit dhe krijimit të një hapësire më të përshtatshme për organizimin e aktiviteteve kulturore, sociale dhe komunitare.

PËRFUNDIM

Në përfundim të dëgjimit publik, kërkesat e paraqitura nga banorët e fshatit **Gorazhdec** u evidentuan dhe u regjistruan si nevoja dhe prioritetet të ngritura nga komuniteti gjatë procesit të konsultimit publik për Propozim-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Kërkesat e paraqitura kanë të bëjnë me:

Përmirësimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik;

1. Rregullimin e parkut dhe krijimin e hapësirës për lojëra për fëmijë;
2. Rrethimin e varrezave;
3. Rritjen e sigurisë në komunikacion pranë shkollës;
4. Mbështetjen e bujqësisë përmes sigurimit të makinerisë bujqësore;
5. Rregullimin ose ndërtimin e kanalit të ujitjes;
6. Trajtimin dhe rregullimin e çështjes së digës;
7. Menaxhimin dhe trajtimin e problemit të qenve endacakë dhe
8. Renovimin dhe rregullimin e Shtëpisë së Kulturës.

Të gjitha kërkesat e paraqitura nga banorët gjatë dëgjimit publik do të përcillen për shqyrtim dhe trajtim të mëtejshëm te drejtoritë dhe strukturat kompetente të Komunës së Pejës. Mundësia e realizimit të tyre do të vlerësohet në përputhje me kompetencat institucionale, prioritetet e përcaktuara dhe mundësitë buxhetore. Ky procesverbal është hartuar me qëllim të evidentimit të kërkesave, propozimeve dhe prioritetëve të paraqitura nga banorët e fshatit Gorazhdec gjatë dëgjimit publik të mbajtur më **05.08.2026**, në kuadër të procesit të konsultimeve publike për hartimin e **Propozim-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027**.

Procesmbajtësi:Gazmend Turku



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik në Fshatin Gorazhdec

Vendi: Qendra Rinore në Gorazhdec

Data: 05.08.2026 05.08.2026

Ora: 16:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	DARIKO DIMITRIJEVIC	RADIO GORAZDEVAC	
2	LUIKA ZLATIČANIN	GORAZDEVAC	
3	DANILO PORTIĆ	GORAZDEVAC	
4	Tomislav Maksic	GORAZDEVAC	
5	Kristijan Mijovic	Toponagabac	
6	Dani Mijovic	GORAZDEVAC	
7	Bojan Mijovic	Toponagabac	
8	SASA PETROVIC	RADIO GORAZDEVAC	
9	FAHIL ZEKAJ	VK PEJE	
10	DANIJAL PORTIĆ	RADIO GORAZDEVAC	
11	Edvin Imamović	DBI	
12	Mirza Džegović	Komuna	
13	Edvin Imamović	K. Peje	
14			
15			
16			
17			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me gra, vajza, klubet sportive të vajzave, organizatat e grave dhe organizatat, që veprojnë në fushën e barazisë gjinore.

Salla e Kuvendit Komunal të Pejës

Dëgjimi ka filluar në ora: 16:00

Datë: 06.08.2026

Sot, në ora 16:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës u mbajt dëgjimi buxhetor me gra, vajza, klubet sportive të vajzave, organizatat e grave dhe organizatat, që veprojnë në fushën e barazisë gjinore, në kuadër të procesit të hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Diellëza Berisha theksoi se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore:

Paga dhe mëditje – 21,481,142.49 €

Mallra dhe shërbime – 4,985,490.00 €
Shpenzime komunale – 1,157,240.00 €
Subvencione dhe transfere – 1,930,626.00 €
Shpenzime kapitale – 14,565,179.51 €.

Gjithashtu, u bë e ditur se Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027. Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës organizohen nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Ardita Bala: Jam nga Qendra për Mirëqenien e Gruas dhe po më vjen mire, që janë rritur subvencionet. Megjithatë, do të ishte e rëndësishme, që të ketë më shumë mbështetje edhe për gratë, e jo vetëm për sektorin e bujqësisë. Ne, të cilët ofrojmë shërbime sociale, përfitojmë nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit. Dëshiroj të theksoj edhe një çështje, që është premtuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, që ka të bëjë me pagesën e qirasë për gratë pas daljes nga strehimi. Vetëm këtë vit, dy gra kanë përfituar pagesën e qirasë për një periudhë dyvjeçare. Megjithatë, numri i grave, të cilat kanë nevojë për këtë mbështetje, po rritet çdo ditë. Prandaj, propozoj që për vitin e ardhshëm të parashihet mbështetja për të paktën 10–20 gra për pagesën e qirasë. Ju faleminderit.

2.Shefkije Haxhiaj: Jam Kryetare e Aktivit të Gruas Pensioniste të Pejës dhe deri më tani nuk kemi pasur asnjë lloj përkrahjeje. Kërkesa jonë kryesore është që të na sigurohet një lokal apo zyrë në qendër të qytetit, ku mund të zhvillojmë aktivitetet tona. Jemi një grup i madh grash, por për shkak të temperaturave të larta nuk kanë mundur të marrin pjesë të gjitha në këtë takim. Ne zhvillojmë vazhdimisht aktivitete të ndryshme, si joga, ushtrime aerobike dhe ecje, të cilat kontribuojnë në mirëqenien dhe shëndetin e grave pensioniste. Një hapësirë e dedikuar do të na mundësonte organizim më të mirë dhe zgjerim të aktiviteteve tona.

Drejtoresha Berisha ju kthej përgjigje të gjithave me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre. Dëgjimet buxhetore janë duke vazhduar dhe janë duke u evidentuar të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve për t'u reflektuar në buxhetin përfundimtar të vitit 2027.

Drejtoresha Berisha takimin e mbylli në ora 17:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik me, Gra, vajza, klubet sportive të vajzave, organizatat e grave dhe organizatat që veprojnë në fushën e barazisë gjinore.

Vendi: Asamble Komunale

Data: 06.08.2026

Ora: 16:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	ARDITA RAKICI BIAN	QTK	Ardu
2	Synderz Nijftari	Pemxionere	Synderz
3	Hilima	039 392 911	Hilima
4	Shefki Hoxhi	44426556	Shefki
5	Vedatice Beklli	ABPD	Vedatice
6	Drita Pajaziti	029. Ruziçit Pejë	Drita Pajaziti
7	DRITA KRASHNICI	K.K. Pejë	Dr. Krashnici
8	Lotuf Hoxhi	K.K.	Lotuf
9	Diellena Bousha	K.K. Pejë	Diellena
10	Fatmir Imam	DBR	Fatmir
11	GRIGOR TUCI	K. Pejë	Grigor
12			
13			
14			
15			
16			
17			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – Me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq, lidhur me Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

SHFMU "28 Nëntori", në Raushiq

Dëgjimi ka filluar në ora: 17:30

Datë: 06.08.2026

Në ora 17:30, në SHFMU "28 Nëntori" në Raushiq u mbajt dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq, lidhur me Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Qëllimi i dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këtë dëgjim morën pjesë Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani dhe Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha bëri të ditur se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49 euro;
Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00 euro;
Shpenzime komunale: 1,157,240.00 euro;
Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00 euro dhe
Shpenzime kapitale: 14,565,179.51 euro.

Gjithashtu, u bë e ditur se Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Bexhet Alimehaj: Përshëndetje për të gjithë kërkesat për planifikimin e buxhetit 2027 për fshatin Lybeniq janë: zgjerimin e ndriçimit në rrugën Himë-Lybeniq me 10 trupa ndriçimi dhe një mbi burimin e kronit të madh, përfundimin e rrugëve me asfalt, që ishin paraparë për këtë vit e që janë rruga "Dardan Alimehaj", "Motrave Ukshinaj", "Smail Ukshinaj" etj., ndërsa rrugët, të cilat kanë nevojë për vitin 2027 janë: zgjerimin e kanalizimit dhe lidhjen e tij me impiant apo një zgjidhje tjetër, vazhdimin e kanalit të ujitjes nga burimi Kroni i Arneshes – Zabloq me gjatësi 200 metra, kanali i ujërave të shiut, "Përroi i bletës" me gjatësi 240 metra, i cili u përmbyt këtë vit, shtëpia e fshatit muze, rruga e bjeshkës, ujësjellësi dhe tre rrath për qarkullim në fshat.

2.Bekim Morina: Përshëndetje për të gjithë dhe në veçanti për Zyrën e Informimit Publik, të cilët bëjnë një punë jashtëzakonisht të madhe. Kërkesat tona kanë të bëjnë me shkollën e fshatit. Ne e kemi një informatë që ka me fillu vitin e ardhshëm. I kemi 1,600 metra prej Liridonit, pastaj 600 metra, rruga "Bajram Shala", 4 metra gjerësi, që e lidh Loxhën me Raushiqin. Rruga "Valon Shala" kanë mbetur edhe 450 metra. Ndërsa, sa i përket ndriçimit, shtyllat e drurit po i rrezikojnë banorët dhe duhet të zëvendësohen. Po ia kaloj fjalën bacës Osman, se unë kërkesat do t'i paraqes me shkrim dhe kohë pas kohe do t'i adresoj edhe në Asamblenë Komunale të Pejës.

3.Osman Mulliqi: Ne i kemi kërkesat e njëjta që i kemi pas. Problemet me kanalizim, pastaj kemi nevojë për asfaltim të rrugëve. Është bërë një punë e mirë. Në disa rrugë brenda fshatit i kemi rreth 950 metra, i kemi të shënuara. Vazhdimin e kanaleve të ujitjes i kemi të identifikuar 4 deri në 5 kanale: një e kemi te Kastrat, një te Haxhiajt, një te shkolla, pastaj

trotuaret, rrugën kryesore, pastaj shkollës me ia rregullu ndriçimin e oborrit. Të gjitha kërkesat do t'i bëj edhe në mënyrë zyrtare.

4.Shaban Tahiraj, nga Raushiqi: Na mungojnë trotuaret, ndriçimi i lagjes, ujërat e zeza, problemet me kundërmimet nga erërat. Ujë nuk kemi.

5.Miftar Aliaj: E kemi një rrugë prej xhamisë së Loxhës, si dhe për varreza, e kemi paraqitur një kërkesë, si dhe për ndriçimin e fshatit.

6.Shpat Kastrati: Për shkak të pamundësisë, që të jem pjesë e dëgjimeve buxhetore për fshatin Raushiq, Pejë, në cilësinë e qytetarit dhe banorit të këtij fshati, kërkoj nga ana juaj, që në kuadër të mundësive buxhetore, të realizohen këto projekte për këtë lokalitet, siç janë: Rregullimi i trotuarit në fshatin Raushiq, nga lagja e "Çoçave" deri te dalja në rrugën kryesore, te pompa e derivateve D.H.F. Rruga në mes të fshatit Raushiq është mjaft e frekuentuar, prandaj rregullimi i trotuarit është i domosdoshëm për sigurinë e këmbësorëve, veçanërisht të fëmijëve, nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi.

Rruga "Mark Krasniqi", asfaltimi i rrugës Kastrat–Morinë, me qëllim të krijimit të një lidhjeje më të mirë ndërmjet fshatit Raushiq dhe fshatit Loxhë të Pejës.

Vendosja e ndriçimit publik nga rruga e Kastratëve deri te stacioni i pritjes së autobusëve, te pompa e derivateve D.H.F. Arsyeja e vendosjes së ndriçimit është rritja e sigurisë së qytetarëve, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes dhe gjatë stinës së dimrit, si dhe shmangia e rrezikimit të fëmijëve nga qentë endacakë. Duke shpresuar se kërkesat e lartcekura do të merren në konsideratë dhe do të përfshihen në planifikimet buxhetore, ju falënderoj për mirëkuptimin dhe angazhimin tuaj.

Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Takimet në kuadër të dëgjimeve buxhetore do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ndërsa të gjitha kërkesat, propozimet dhe rekomandimet e qytetarëve, po evidentohen dhe do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të Projekt-Buxhetit.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik në fshatrat Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.

Vendi: Shkolla fillore në Raushiq

Data: 06.08.2026

Ora: 17:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Tahir Shalizi	F. Llozhan	Tahir Shalizi
2	Gazmend Shaka	-	Gazmend Shaka
3	MIFTAR ALIPI	F. Zllapek	Miftar Alipi
4	Belim Morina	F. Llozhan	Belim Morina
5	Bechir Ahmeti		Bechir Ahmeti
6	ADEM BERISHA		Adem Berisha
7	Osman Mulla		Osman Mulla
8	Samir Lekaj		Samir Lekaj
9	ARIF TOPI		Arif Topi
10	SHABAN TAHIRAJ		Shaban Tahiraj
11	Ulet Himaj	F. Raushiq	Ulet Himaj
12	Bendi Morina	F. Llozhan	Bendi Morina
13	Fatmir Jorgji	K.K. Peja	Fatmir Jorgji
14	SHIPESA LUKA	Q.P.S.	Shipesa Luka
15	DETA KASAPI	K.K. Peja	Deti Kasapi
16	GJERGJ TOSKA	K.B.S.	Gjergj Toska
17			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2027

Procesverbali – ME BANORËT E FSHATRAVE TË LUGUT TË BARANIT DHE TË LESHANIT

Më 07.08.2026, në SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Baran, në ora 17:30 kanë filluar dëgjimet buxhetore me banorët e fshatrave të Lugut të Baranit dhe të Leshanit, lidhur me Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027, si dhe ofrimi i mundësisë, që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Në këto dëgjime ishin të pranishëm Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani dhe Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, z.Tahir Shala.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj bëri të ditur se bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Qeverisë, buxheti i ndarë për Komunën e Pejës për vitin 2027 është 44,119,678.00 euro.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori buxhetore:

Paga dhe mëditje: 21,481,142.49 euro;
Mallra dhe shërbime: 4,985,490.00 euro;
Shpenzime komunale: 1,157,240.00 euro;
Subvencione dhe transfere: 1,930,626.00 euro;

Shpenzime kapitale: 14,565,179.51 euro.

Gjithashtu, u bë e ditur se Komuna e Pejës ende nuk e ka pranuar Qarkoren e Dytë Buxhetore, e cila pritet të sjellë të dhëna shtesë dhe mund të ndikojë në finalizimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2027.

Dëgjimet publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës janë organizuar nga Grupi Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezentoheni dhe e hapim diskutimin.

1.Ardit Gërvalla: Përshëndetje për të gjithë, po i paraqes disa kërkesa, që janë prioritare për banorët e kësaj zone, duke kërkuar, që të përfshihen në Projekt-Buxhetin 2027, siç janë:

Zgjerimin dhe rregullimin e plotë të lumit Behoc, nga fshati Kryshec deri në Nepole, për shkak të dëmeve të mëdha, që shkakton gjatë vërshimeve.

Përfundimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në fshatin Kryshec.

Lidhjen e kanalizimit të lagjes “Gërvallaj” me impiantin e trajtimit të ujërave në Kryshec, si një zgjidhje e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe eliminimin e kundërmimit të “Përroi i Gërvallës”.

Asfaltimin e rrugëve, që ende kanë mbetur të paasfaltuara në fshatin Kryshec.

Mirëmbajtjen e trotuareve ekzistuese nga ana e Komunës, me qëllim rritjen e sigurisë për këmbësorët.

Vendosjen e pritoreve për qytetarët në të gjitha fshatrat përgjatë Lugut të Baranit, për t’u siguruar kushte dinjitoze për pritjen e transportit - autobusëve.

Ndërtimin e urës në fshatin Kotradiq, një investim i domosdoshëm për lehtësimin e qarkullimit dhe lidhjen e banorëve.

2.Agron Kelmendi: Përshëndetje për të gjithë, po vazhdoj me kërkesat e banorëve të fshatit Kosuriq, siç janë:

Trotuari nga qendra e fshatit deri tek Shkolla „Migjeni“.
 Penda e Kratinës me kanal ujitjeje, gjatësia e tij 1,500 metra (ujitje 60 hektarë).
 Ura e fshatit në qendër, zgjerimi dhe ngritja e saj.
 Rrethojat e varrezave të fshatit.
 Kanali për ujitje nga Rugova deri te Maznikolli.
 Asfaltimi i parkingut, zgjerimi i rrugës për tek varrezat.
 Ndriçimi i fshatit.
 Vazhdimi i kanalit prej qendrës deri tek ura e Adem Kadrisë.
 Riemërtimi i rrugës Tuljezhit në „Tre Dëshmorët“.
 Kanali për ujitje të Ali Gashit nga ish-drejtori i shkollës.
 Ngritja e kanalit tek Rugova dhe zgjerimi i rrugës aty.
 Asfaltimi i rrugës tek Zenel Kelmendi dhe në qendër të fshatit.
 Hapësira për këndin e lojërave afër shtëpisë së fshatit.
 Kanali i ujitjes në Serisht, gjatësi 300 metra.
 Menaxhimi i mbeturinave, mos hyrja e mbledhjes në qendër në drejtim të varrezave.

3.Metush Krasniqi: Në Kryshec kemi nevojë për një shtëpi pritjeje. Te Kryetari Muhaxheri kam qenë dhe më ka thënë se besoj që do të veprojmë. Pastaj kemi nevojë për 750 metra asfaltim para një kulle, e cila është kullë e moçme, si dhe asfaltimin e hyrjes. Të gjitha kërkesat do t'i sjell në komunë me shkrim.

4.Anton Antoni: Është shumë urgjente rruga në drejtim të Shqiponjës. Kanë mbetur 40 metra gjatësi, gjerësia është 2 metra dhe lartësia është 1.40 metra. Aty po bëhet shembja e urës. Urën nuk e mirëmban komuna, por shkaku i asaj ure ka mbetur pa u rregulluar. Janë rregulluar rreth 200 metra, ndërsa rrezikshmëria për qytetarët, të cilët kalojnë andej ka kaluar, por te pjesa e tokave aty bëhen të gjitha grumbullimet. Nënkyetar i nderuar, z.Asllani, është bërë një punë e jashtëzakonshme, të cilën e shohin qytetarët edhe në fshatrat e tjera, Nepole, Kosuriq. Unë e them me shumë krenari se, me ardhjen e kryetarit Muhaxheri, ka bërë mrekulli edhe në Gllogjan, Llugaxhi, sepse asgjë nuk do të kishim mundur të bënim pa ndihmën e komunës. Pastaj, mungesë është rryma, e cila nuk është faji juaj. S'kemi rrymë në këtë kohë, tërë ditën e gjatë, në këtë temperaturë të madhe. Kërkesat me shkrim do të vijmë t'i dorëzojmë.

5.Mark Kabashi, përfaqësues i fshatit Gllogjan: E kemi problem zgjerimin e prrojeve. Një reshje më e vogël, menjëherë po del prej shtratit dhe ka kaluar në këtë rrugën, që është ndërtuar tash, Gllogjan-Llugaxhi, që nuk po dihet a është asfalt apo lumë. Mirëmbajtjen e rrugëve e kemi problem. Rruga, që është ngushtuar shumë, rruga Gllogjan-Vokshiq, edhe rruga Gllogjan-Llugaxhi, ku është e nevojshme edhe hapja e atyre kanaleve, që të mos dalë uji dhe të dëmtojë asfaltin. Por kemi nevojë edhe për mirëmbajtjen e mexhave, se mezi po

përballen makinat mes vete. Edhe një kërkesë e veçantë është se shumë vite e kemi bërë kërkesën për kanal të ujitjes, mbi 100 hektarë, që janë të nevojshëm për t'u ujitur, por ujiten në mënyrë primitive.

6.Demë Gashi, kryetar i Bashkësisë Lokale të Baranit: Mua më së shumti më intereson çështja e ujësjellësit?

7.Atdhe Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket bujqësisë, furnizimi me mekanizëm bujqësor dhe pajisje të tjera përcjellëse është në rregull, ndërsa këto të tjerat jo mirë të realizuara. Për shembull, rrethojat e fshatit Çallapek rezultojnë me defekte të jashtëzakonshme. Kërkesë e kemi vazhdimin e ndërtimit të kanaleve të ujitjes, ndërtimin e tri pendave, zgjerimin e ndriçimit, por na ka mbetur një pjesë në lagjen "Kamenicë". Ndërtimi i tri pendave dhe urave, hapja e shtretërve të lumenjve, vitalizimi i kanalit të ujitjes në lagjen "Kamenicë". Varrezat e fshatit Çallapek, të lagjes "Kamenicë", ndodhen në një pjesë të shpatit. E kemi diskutuar herën e fundit që të bëhet, janë rreth 200 metra, të ketë një mur mbrojtës. Po ashtu, e kemi një lagje brenda lagjes "Kamenicë", ndërmjet shtëpive, ku na duhet të ndërtohet një rrugë.

8.Veton Dervishaj, përfaqësues i fshatit Kotradiq: Kemi nevojë për pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe digës, ndërtimin e urës mbi lumin Bistrica e Deçanit, e cila lidh mbi 50 hektarë toka bujqësore. Çka është me rëndësi këtu, e kemi të ndarë edhe një parcelë, që e kemi caktuar për varreza dhe kemi nevojë shumë të madhe, që të jetë kjo urë dhe të kemi qasje për ta shfrytëzuar atë parcelë për këtë qëllim. Pastaj, nuk kemi rrjet të kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në kanalet përgjatë fshatit.

9.Driton Gashi, përfaqësues i fshatit Buqan: Na kemi problem me reshjet atmosferike dhe rrezikohen banorët dhe shtëpitë afër. Rreth 60 metra na duhen. Pastaj, rruga Buqan-Kamenicë, që e lidh Baranin, dhe disa rrugica të fshatit.

10.Selman Krasniqi: Rruga kryesore nuk mirëmbahet dhe është kompetencë e Qeverisë. A ka kush që merret me këtë çështje dhe të dimë ne se dikush e ka tenderin, por nuk interesohet për mirëmbajtjen e rrugës?

Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, z.Tahir Shala i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se subvencionet për bujqësi janë dyfishuar, ndërsa projekti kryesor për vitin e ardhshëm në Luginën e Baranit do të jetë projekti i ujësjellësit, mbi 1 milion euro do të jetë investimi.

Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Të gjitha kërkesat, propozimet dhe rekomandimet e qytetarëve janë evidentuar dhe do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

Me dëgjimet publike të mbajtura sonte janë përmbyllur të gjitha dëgjimet e organizuara për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027.

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:00.

Procesmbajtësja: Ariana Lukaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik në fshatrat e Lugut të Baranit

Vendi: Shkolla fillore në Baran

Data: 07.08.2026

Ora: 17:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Muhamet Berisha	B.L. Gjergj	
2	ANTON ANTONI	B.L. Gjergj	
3	ARDIT GERVALLA	ASAMBLIST	Gjervalla
4	Dene Gashi	K.K. LOKAL	
5	BESIM GASHI		
6	Naim Krasniq	Destinor	
7	MARK KABASHI	K. GILLOGIAN	
8	Nehmedin Berish	Sham enica	
9	Shkambin Krasniq	Vranoc	
10	Faik Krasniq	VRANOC	
11	SKENDER KRASNIC	VRANOC	
12	Zipmer Berisha	Dallapek	
13	Adem Berish	Gallapek	
14	Naim Krasniq	Gallapek	
15	Naim Krasniq	Kotradic	
16	ADAM KEMENI	KOSORIC	
17	JOZEF ANTONI	GILLO GJATU	

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
18	JETMIR GJOCAJ	KOTRADIO	<i>[Signature]</i>
19	ERMIR GJOCAJ	KOTRADIO	<i>[Signature]</i>
20	TATIR SHAJA	BARAN	<i>[Signature]</i>
21	ADRI GASHI	BARAN	<i>[Signature]</i>
22	SELMON KRASNICI	VRANOC	<i>[Signature]</i>
23	FLORENT GASHI	BARAN	<i>[Signature]</i>
24	SKELCEN GASHI	BARAN	<i>[Signature]</i>
25	DRILON GASHI	BARAN	<i>[Signature]</i>
26	Vetran Drenthaj	KOTRADIO	<i>[Signature]</i>
27	EDIN BOJARI	GALLAPSK	<i>[Signature]</i>
28	Almet Gashi	BARAN	<i>[Signature]</i>
29	Dritom Gashi	Bucam	<i>[Signature]</i>
30	GABRIEL TURK	K. 16-6	<i>[Signature]</i>
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48	JE		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Lista e Nënshkrimeve të Pjesëmarrësve në Dëgjimin Publik në fshatrat e Lugut të Leshanit

Vendi: Shkolla fillore në Qyshk

Data: 07.08.2026

Ora: 19:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	Adrian GAVRI		Adrian
2	SEJFI QEKU		Sejfi
3	BALI META		B.Meta
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			